



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP. Anr. 48/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Skender Çoçaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit Politik Za, Slobodu, Pravdu i Opstanak me seli në Komuna Graçanicë, parashtruar kundër Srpska Lista me seli në Komuna Mitrovicë e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.48/2025, e datës 27.12.2025, parashtruar nga Subjekti Politik Za, Slobodu, Pravdu i Opstanak me seli në Komuna Graçanicë, paraqitur kundër Subjektit Politik Srpska Lista me seli në Komuna Mitrovicë e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Më datë 27.12.2025 në PZAP-i, është parashtruar ankesë, në të cilën pretendohet se aktivistët e subjektit politik "Za, Slobodu, Pravdu i Opstanak", ndërsa mbikëqyrnin aktivitetet e subjekteve të tjera politike, vunë re se përkrahësit e subjektit politik "Lista Serbe", në qendër të Leposaviçit, kanë ekspozuar një bilbord të madh që ndodhet në 20 metra përballë qendrës për numërimin dhe në më pak se 50 metra nga vendvotimi, gjë që është në kundërshtim me kodekset ligjore për subjektet politike duke përdorur objekte për promovim dhe duke shkelur rregullat e fushatës zgjedhore, duke qenë se ata kanë vendosur bilbordin në një vend ku nuk është parashikuar për këtë.

Më tej në ankesë theksohet se në bazë të dispozitave ligjore në fuqi që lidhen me ciklin zgjedhor dhe rregullat, duke qenë se shkelja ka ndodhur më 27.12.2025 në orën 13:00, kërkojnë nga PZAP që të pranojë ankesën si të bazuar, dhe të miratojë një vendim me të cilin

dënohet subjekti politik "Lista Serbe" - Zlatan Elek, në përputhje me normat dhe rregullat ligjore që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Bashkëngjitur në ankesë janë fotografi të posterëve ngjitur nga Srpska Lista në Leposaviç.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik Srpska Lista, sqarojnë se në lidhje me ankesën e Subjektit Politik Za, Slobodu, Pravdu i Opstanak, e cila ka të bëjë me vendosjen gjoja të paligjshme të materialit promovues në vende ku kjo nuk është e lejuar, përkatësisht "se posteri ynë promovues ndodhet në 20 metra nga qendra komunale për numërimin e votave dhe në më pak se 50 metra nga qendra votuese". Theksojnë se posteri i vendosur është në më shumë se 70 metra nga qendra komunale për numërimin e votave, dhe se është vendosur me vendimin e kryetarit të komunës së Leposaviqit, me detyrim që ai të hiqet më 28.12.2025, para se qendra komunale për numërimin të fillojë punën.

Më tej në përgjigje theksojnë se materiali ndodhet në një pozicion të tillë që vizualisht është e pamundur të ketë kontakt me qendrën komunale për numërimi dhe se materiali i përmendur ndodhet në më shumë se 150 metra nga qendra votuese, gjë që është në përputhje me ligjin.

Në mbështetje të kësaj përgjigjeje kanë bashkëngjitur vendimin e kryetarit të komunës së Leposaviqit për vendosjen e këtij materiali me kërkesë të subjektit politik Srpska Lista, si dhe nënshkrimet e banorëve që kanë dhënë pëlqimin për vendosjen e këtij materiali.

Prova: Fotografitë e dokumenteve të bashkëngjitura

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore si dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Srpska Lista, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik ZSPO, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se "*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.*"

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së nenit 34 par.1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkëngjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, dokumentet e bashkëngjitura, Pëlqimin nga Komuna e Leposaviçit si dhe pëlqimin e banorëve për vendosjen e posterit, vërtetoi se vendosja e të njëjtit nga Subjekti Politik Srpska Lista, është në pajtim me nenin 7 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, Materialet e Fushatës Zgjedhore konkretisht paragrafi 3 në të cilin nen në mënyrë decitive thuhet se "*Materialet e shtypura të zgjedhjeve, mund të ekspozohen brenda dhe jashtë objekteve në pronësi private, ndërtesave, strukturave ose objekteve tjera përveç atyre të saktësuara në paragrafin 2 të këtij neni, pas miratimit paraprak të pronareve të tyre*

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se “*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.48/2025 më datën 29.12.2025

**Kryesues i Panelit,
Skender Çoçaj**



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.